

DEKRET
Nr.204, datë 5.6.1992

PËR PASURINË E SINDIKATAVE

Në mbështetje të pikës 19 të nenit 28, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Sindikatat në Republikën e Shqipërisë kanë pasuri dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike e socialkulturore duke hyrë në marrëdhënie juridike civile me persona juridikë e fizikë, vendas e të huaj, për të kryer veprimtari sindikale dhe për edukimin profesional të punonjësve.

Neni 2

Pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme që shërben për veprimtarinë sindikale dhe edukimin profesional e sindikal të punonjësve, si shtëpi pushimi, shtëpi kulture e parqe sportive, salla mbledhjesh e veprimtarish, sanatoriume për punonjësit, librari, biblioteka, ndërtesa shkollimi, makineri, pajisje dhe inventar i imët, është në pronësi të sindikatave.

Ndarja e kësaj pasurie bëhet me marrëveshje ndërmjet sindikatave në përpjestim me numrin e anëtarëve të tyre, brenda muajit qershor të vitit 1992. Mosmarrëveshjet që lidhen me ndarjen e pasurisë, zgjidhen nga gjykata.

Neni 3

Pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme dhe vlerat monetare të ish-Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë të bllokohen, inventarizohen dhe vlerësohen nga një komision i ngritur nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, duke marrë si bazë gjendjen faktike të muajit mars të vitit 1991.

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha